

i tij është i njohur për FDH] u tha Halilit dhe Bardhyli se Hyseni ishte në burg, se kundër tij po zhvilloheshin hetime, se ai ishte i bindur se Hyseni ishte “i pastër” dhe se do ta lëshonin shumë shpejt. Një muaj më vonë [më 5.07.1998], me lejen e komandantit të shtabit të UÇK-së, Selim Krasniqi, Halili e ka vizituar Hysenin. Pas kësaj, ai e ka vizituar edhe disa herë të vëllain në burg, duke i çuar cigare dhe rroba. Kur, disa ditë më vonë, filluan konfliktet e UÇK-së me forcat serbe, Selim Krasniqi i tha Halilit se Hysenin e kishin transferuar në fshatin fqinj të Zatriqit/Zatrić. Bardhyli shkoi menjëherë në Zatriq/Zatrić, ku një pjesëtar i UÇK-së i tha se askush nuk ishte sjell nga Drenoci/Drenovac. Fati i Hysenit nuk është ndriçuar deri më sot. Emri i tij gjendet në listën e të zhdukurve të KNKK-së dhe lënda e tij e mban numrin rendor YUK-050104-01.

Në muajin prill të vitit 2009, Gjykata Supreme e Kosovës i ka dënuar pjesëtarët e policisë ushtarake Selim Krasniqin, Bedri Zyberajn dhe Agron Krasniqin me dënime shumëvjeçare me burg, për shkak të ndalimit të paligjshëm dhe trajtimit çnjerëzor të Hysen Krasniqit dhe të burgosurve të tjerë në burgun e UÇK-së në Drenoc/Drenovac.

Burimet: deklarata H.K, FDH-33027; Gjykata e Qarkut Prizren, K. num. 85/2005 (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.08.2006, FDH-33923; Gjykata Supreme e Kosovës, K.Z. 371/2008, (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.04.2009, FDH-29712; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; AIS, *Zona...*, 59, FDH-16913.

Jugoslav (Dragoljub) Kostić

(6.01.1970, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, rojtar)

Jugoslavi ka jetuar në bashkësi familjare me prindërit e vet në fshatin Reti/Retimlje. Punonte si rojë në repartin e Kombinatit Bujqësor *Orvin – Shpati i Brestovcit/Brestovačka padina*, në **Brestoc/Brestovac**. Në mbremjen e ditës së premte, më 10.07.1998, Jugoslavi shkoi në punë, në ndërresën e natës. Nuk u kthye në shtëpi në mëngjesin e ditës tjetër. I vëllai Saško

shkoi për të mësuar çfarë kishte ndodhur më Jugosllavin. Në tavolinën e tij të punës e ka gjetur çantën me bukën, të cilën i vëllai e kishte marr prej shtëpisë, por nuk kishte asnjë gjurmë tjetër të tij. Familjarët nisën të interesoheshin për fatin e Jugosllavit gjithandej. Dy ditë më vonë, një shqiptar [identiteti i tij është i njohur për FDH] i solli familjes një letër nga Jugoslavi, në të cilin ai porosiste se ishte mirë, se e kishin arrestuar dhe se kusht për lirinë e tij ishte që serbët e Retisë/Retimlje t'i dorëzonin të gjitha armatimet. Babai i Jugosllavit, Dragoljubi, i tha këtij shqiptari se armët ishin pronë “shtetërore” dhe se, për këtë gjë, atij i duhej të pyeste në SPB. Por, i ofroi para dhe arën si kompensim për lirinë e të birit, gjë që ky person e refuzoi. Më vonë, Dragoljubit i thanë në SPB-në e Rahovecit/Orahovac se nuk i lejohej t'i dorëzonte armët. Për fatin e Jugosllavit nuk dihet asgjë as sot. Në regjistrin e të zhdukurve të administruar nga KNKK-ja, rasti i tij është evidentuar në lëndën me numër YUK-050095-01.

Burimet: deklarata L.K, FDH-583; deklarata O.B, FDH-3900; deklarata V.K, FDH-13527; deklarata M.N, FDH-460; deklarata M.D, FDH-470; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; AIS, *Zona...*, 61, FDH-16913; *Nedopustiva nebriga i neodgovornost*, Oteta istina, num. 15, korrik - shtator 2008, 17, FDH-19947; *Šta je sa otetima*, Ilustrovana politika, 28.11.1998, 7-8, FDH-32281.

Bedri (Samedin) Berisha

(1.05.1966, shqiptar nga Brestoci/Brestovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, pesë fëmijë)

Në datën 3.06.1998, Bedriu ka shkuar së bashku me të ëmën Nysreten për një vizitë te daja i vet, Islam Hoti, në fshatin Ratkoc/Ratkovac. Nga ora 17:00, dy ushtarë të UÇK-së [emrat e tyre janë të njohur për FDH] erdhën para shtëpisë së Islamit. Filluan të shtëninë në ajër dhe e ftuan Bedriun që të dilte jashtë shtëpisë. Biseduan pak dhe, më pas, e morën me vete. Familjarëve u thanë se po e merrnin Bedriun me vete për ta marr në pyetje dhe se, pas kësaj, do ta kthenin. Disa orë më vonë, djali i dajës së Bedriut ka mësuar se Bedriun e kishin çuar